



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 44 Akti

Nr. 45 Vendimi

Tiranë, më 23.07.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Etleda Çiftja	Anëtare
Xhensila Pine	Relatore

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, më datë 18.07.2018, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Ervin Metalla, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore, si dhe shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Z. Ervin Metalla është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Apelit Tiranë, në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës të Shqipërisë.

Z. Ervin Metalla është kandidat për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, në bazë të nenit 284, pika 9, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, prandaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 30 nëntor 2017 me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga komisioneret Valbona Sanxhaktari, Etleda Çiftja dhe Xhensila Pine relatores.

Pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “KLD”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues nr. 4, me vendimin nr. 1, datë 12.12.2017, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe të caktojë me mirëkuptim kryesuese znj. Valbona Sanxhaktari. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në konflikt interesi.

Më datë 06.06.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Ai nuk deklaroi konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

Më datë 25.06.2018, trupi gjykues vendosi:

- Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Metalla, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke arritur në përfundimin se provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë vetëm për këtë kriter, bazuar në nenin 52, paragrafi i dytë, i ligjit nr. 84/2016.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, si dhe të marrë një kopje të tyre, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

Trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit në të njëjtën ditë, me *e-mail*, për vendimin sa më sipër.

Më datë 09.07.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij së bashku me provat, të cilat u administruan nga ana e Komisionit.

Më datë 12.07.2018, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 3, ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, më datë 18.07.2018, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i 2-të, Tiranë.

Më datë 18.07.2018 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit.

Në shpjegimet e dhëna pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit i paraqiti trupit gjykues kërkesën për përfshirjen edhe të dy komponentëve të tjerë, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional, për të si subjekt rivlerësimi.

Trupi gjykues vendosi, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Metalla, pasi për komponentin e pasurisë provat kanë nivelin e provueshmërisë për këtë kriter sipas ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet dhe provat e paraqitura, nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Metalla, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

PROCESI I VLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË NGA ILDKPKI-ja

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka bërë vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar raportin e detajuar lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

RIVLERËSIMI PËR KRITERIN E PASURISË NGA KOMISIONI

Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; si dhe në vendimet nr. 2 e nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu hetimin e tij të pavarur¹ në vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje pasurie, deklarim të rremë.

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” sipas ligjit nr. 84/2016:

→ Apartament banimi, me sip. 96.8 m², dhe garazh, me sip. 22.5 m², Rr. “(***)”, Tiranë. Vlera 55.000 euro. Pjesa takuese 100 %.

Burimi i deklaruar në deklaratën “Vetting”:

- kredi nga “Alpha Bank”, sipas kontratës së huas datë 25.07.2007;

¹ “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozitë ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisioneri Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut V2 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- shtesë e kontratës “Kufi kredie, shumë qëllimor”, datë 25.07.2007, me afat shlyerjeje 20 vjet, me interes 5.7 %;
- kontratë nr. (***) , për ndryshimin e kontratës për kufirin e kredisë, datë 11.04.2011, e lidhur mes “Alpha Bank”, kredimarrësit/debitori E. e Xh. M. dhe palës së tretë, Ervin Metalla, si debitor i mëparshëm;
- kredi me kushte lehtësuese nga Banka Kombëtare Tregtare (zëvendësuar shtesën e kontratës kufi kredie), datë 22.09.2011, mes “BKT”-së dhe kredimarrësit Ervin Metalla dhe dorëzantës janë E. M. e Xh.M.

1. Në lidhje me sipërfaqen, katet e banimit, datën e blerjes dhe kohën kur ka filluar të banojë.

1.1 Faktet nga hetimi administrativ

1.1.1 Në vetëdeklarimin për legalizimin e shtesës nga pronari i mëparshëm, shtetasi E. H., përshkruhet: “Objekt banimi 50 m² mbi shtesën anësore (*shtesë, kati i 3-të*) dhe 30 m² mbi tarracën e pallatit ekzistues (*profil i lehtë*). Objekti, kati i 4-ërt, me hyrje më vete nga pallati ekzistues.

1.1.2 Referuar gentplanit të gjendur në dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja, rezulton se është apartamenti nr. 4, në katin e 5-të të pallatit nr. 85/5, të ndodhur në Rr. “(***)”, kurse referuar planimetrisë së katit të 4-ërt, ai ka një sipërfaqe prej 96.8 m².

1.1.3 OSHEE-ja konfirmon në emrin e subjektit të rivlerësimit kontratën (***) , me adresë në Rr. “(***)”, pall. (***) , me datë hapjeje të kësaj kontrate 24.02.2002.

1.1.4 Nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite, në lidhje me adresën e vendbanimit, është deklaruar si adresë vendbanimi Rr. ‘(***) , pall. (***) , ap. (***) , Tiranë, që prej vitit 2004, veprimet juridike për blerjen e apartamentit nr. (***) rezultojnë në vitin 2007.

1.1.5 Në përgjigje të pyetësorit të dytë drejtuar subjektit të rivlerësimit, pyetjes se kur ka nisur të jetojë në pallatin nr. (***) në Rr. “(***)”, subjekti i rivlerësimit i përgjigjet: “*Nga viti 2003, deri në fillim të vitit 2008 kam banuar si qiramarrës i qiradhënësit E. H., në apartamentin nr. (***) , në katin e (***) të pallatit, që i korrespondonte shtesës anësore të tij, të palegalizuar dhe të paregjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*”.

1.2 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për mospërputhjet midis:

- i) sipërfaqes dhe kateve të banimit;
- ii) datës së blerjes së apartamentit;
- iii) kohës kur ka filluar të banojë në këtë apartament dhe me çfarë tagri ligjor.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi si më poshtë:

1.2.1 Vetëdeklarimi lidhur me përmasat e apartamentit të formuar nga shtesa anësore dhe shtesa mbi kat është kryer me përafërsi nga vetë shtetasi deklarues (*shitësi*) E. H., siç rezulton nga formulari përkatës i vetëdeklarimit më datë 15.09.2006.

1.2.2 Më pas, kanë qenë ekspertët e ALUIZNI-t ata të cilët kanë kryer këqyrjen e objektit dhe matjet e sakta, para miratimit të lejes së legalizimit, siç e përcaktonte procedura përkatëse për këto raste.

1.2.3 Pra, në përfundim të procesit të legalizimit, leja e legalizimit ka dalë bazuar në përmasat dhe sipërfaqen që i ka rezultuar ALUIZNI-t dhe jo duke iu referuar vetëdeklarimit të shtetasit E. H.

1.2.4 Për herë të parë, sipërfaqja e apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Metalla, është deklaruar në deklarin periodik për vitin 2013, kohë në të cilën përfundoi procesi i legalizimit dhe regjistrimit në ZVRPP-në Tiranë të këtij apartamenti, si pasuria me nr. (***) , NR regj. hip. (***) .

1.2.5 Është e vërtetë që kontrata me nr. (***) , me adresë në Rr. “(***)” , pall. (***) është hapur më datë 24.02.2002, por kjo nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla, por nga pronari, z. E. H. Më vonë, kur ndryshoi pronësia e objektit të furnizuar me energji elektrike, apartamentit në fjalë, ndryshoi edhe emri i të furnizuarit nga OSSHE-ja.

1.2.6 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se nga viti 2003 deri në fund të vitit 2007 ka deklaruar si adresë vendbanimi Rr. “(***)” , pall. (***) , ap. (***) , Tiranë, pasi përgjatë kësaj periudhe ka banuar si qiramarrës i qiradhënësit E.H., në apartamentin nr. (***) , në katin e tretë të pallatit. Kjo marrëdhënie nuk ka qenë e formalizuar me shkrim.

1.3 Provat e administruara për vërtetimin e fakteve:

- Deklarata e pasurisë dhe dokumentacioni i dorëzuar nga z. Ervin Metalla pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- Deklaratat e interesave private ndër vite, përpara fillimit të detyrës dhe ato periodike/vjetore të dorëzuara pranë ILDKPKI-së në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe prova të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, fizikisht dhe në rrugë elektronike.
- Parashtrimet e tij në seancën dëgjimore të datës 18.07.2018, sipas procesverbalit.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 30.01.2018, nga OSHEE-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 28.02.2018, nga OSHEE-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 29.03.2018, nga UKT-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 13.04.2018, nga ILDKPKI-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 29.12.2017, nga ZVRPP-ja Tiranë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 08.02.2018, nga ZVRPP-ja Tiranë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.01.2018, nga ZVRPP-ja Tiranë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 08.02.2018, nga ZVRPP-ja Durrës.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 26.02.2018 nga ALUIZNI.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 20.04.2018 nga ALUIZNI.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.04.2018, nga ALUIZNI.
- Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës nga shtetasi E. H.
- Deklaratë noteriale me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 06.07.2018, z. E. H., kopje e noterizuar e kontratës për furnizimin e energjisë elektrike për përdoruesit me nr. (***) , në emër të z. E. H.
- Shkresë me nr. (***) prot., datë 05.07.2018, e OSHEE-së, drejtuar z. Ervin Metalla.
- Vërtetim nr. (***) prot., datë 06.07.2008, lëshuar nga shoqëria “ALBTELECOM” sh.a.
- 10 (dhjetë) copë fotografi të kryera nga jashtë pall. (***) , ndodhur në Rr. “(***)” .

Trupi gjykues i konsideroi të panevojshme marrjen e dëshmive të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit nga z. N. D. e znj. B. D., banues në Rr. “(***)” , pall. (***) , ap. (***) , Tiranë, si

dhe këqyrjen e objektit/pallatit nr. (***) , ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë, për arsye se fakti që kërkohet të provohet nga subjekti i rivlerësimit, konsiderohet i provuar gjatë gjykimit të çështjes administrative nga trupi gjykues.

1.4 Arsyetimi ligjor

Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i) nuk ka mospërputhje ndërmjet sipërfaqes dhe kateve të banimit të pasurisë në këtë adresë;
- ii) nuk ka mospërputhje ndërmjet datës së blerjes së apartamentit dhe datës së hapjes së kontratës së energjisë elektrike;
- iii) nuk ka mospërputhje ndërmjet kohës se kur subjekti i rivlerësimit ka filluar të banojë në këtë apartament dhe me çfarë tagri ligjor.

2. Kreditë në “Alpha Bank” dhe “Bankën Kombëtare Tregtare”

2.1 Faktet nga hetimi administrativ për kredinë e marrë nga “Alpha Bank”

2.1.1 Në deklaratën “Vetting”, një ndër burimet për blerjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “(***)” është kredia e marrë në “Alpha Bank”, sipas kontratës për kufi kredie shumëqëllimor me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 26.07.2007, mes “Alpha Bank” dhe kredimarrësit Ervin Metalla, në shumën prej 58.500 eurosh dhe kontratës së huas shtesë e kontratës për kufi kredie shumëqëllimor me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 26.07.2007, mes “Alpha Bank” dhe Ervin Metallës.

2.1.2 Në kontratën paraprake të shitjes, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 18.07.2007, (*te notare Dh. Q.*) mes shitësit z. E. H. dhe blerësit z. Ervin Metalla, për kalimin e pronësisë së apartamentit të ndodhur në Rr. “(***)”, pall (***) , nr. (***) , dhe një garazhi, parashikohet se “Çmimi i shitjes është 75 mijë euro”.

2.1.3 Pas miratimit e disbursimit të kredisë së “Alpha Bank”, më datë 02.08.2007 palët nënshkruajnë deklaratën noteriale me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.12.2007, mes shitësit z. E. H. dhe blerësit z. Ervin Metalla, në të cilën parashikohet se: “*Pas negociimit, palët deklarojnë se çmimi i blerjes së objektit është 55 mijë euro*”.

2.1.4 Në kontratën me nr. (***) rep., nr. (***) kol., lidhur me “Alfa Bank”, datë 26.07.2007, parashikohet se: “*2.1. Kredimarrësi ka paraqitur projektin e blerjes së apartamentit në Tiranë; 2.2 Projekti ka një kosto të përgjithshme prej 75.000 eurosh; 2.3 kontributi i kredimarrësit për financimin e projektit është 20.000 euro dhe pjesa tjetër prej 55.000 eurosh, është kërkuar të financohet nga banka...*”.

2.1.5 Në përgjigje të pyetësorit të datës 2 mars 2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “*Duke qenë se banka, sipas rregullave të saj, nuk financonte më shumë se 70 % të projektit të kredisë, si dhe duke qenë se unë nuk kisha mundësi të financoja diferencën, në nenin 2 të kontratës paraprake në fjalë, u parashikua nga palët se çmimi i shitblerjes së pasurisë do të ishte 75.000 euro dhe se ky çmim, negociimi i të cilit deri në hartimin e kontratës përfundimtare nuk do të mund të kalonte nën vlerën prej 70 % të shumës në fjalë*”.

2.1.6 Për sa më sipër, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit, si vijon:

- Duket se përcaktimet e deklaratës noteriale nr. (***) rep., nr. (***)kol. bien në kundërshtim me parashikimet e kontratës së kredisë me “Alpha Bank”.

- Duket se ndryshimi i çmimit të kontratës paraprake të shitjes u bë për të përfituar financim nga “Alpha Bank” për këtë pasuri, tej normës së lejuar të financimit e në shkelje të parashikimeve të kontratës së kredisë.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, sqaroi se:

2.1.7 Është e vërtetë se në kontratën paraprake të shitjes, me nr. (***) rep., nr. (***)kol., në nenin 2 të saj, palët parashikuan se çmimi i shitblerjes së pasurisë do të ishte jo më shumë se 75.000 (*shtatëdhjetë e pesë mijë*) euro. Çmimi përfundimtar do të përcaktohej pasi të ishte arritur mirëkuptimi se kush do të përballonte shpenzimet e përfundimit të procesit të legalizimit, shitësi apo blerësi, pra, nëse ato do të merreshin përsipër nga shitësi apo nga blerësi, si dhe nga fakti nëse çmimi do të paguhej menjëherë dhe plotësisht nga blerësi ose jo.

2.1.8 Vetë “Alpha Bank” kërkoi, për t’u financuar me kredi për shtëpi, paraqitjen e një projekti, ku banka financonte 70 %, ndërsa subjekti i rivlerësimit pjesën tjetër. Projekti që iu paraqit bankës ishte pikërisht kontrata paraprake e shitjes e sipërcituar.

2.1.9 Vetë “Alpha Bank”, para miratimit të kredisë dhe nënshkrimit të kontratës përkatëse, ishte në dijeni të plotë të faktit se, sipas projektit (*kontrata paraprake e shitjes me nr. (***) rep., nr. (***)kol.*) që po financonte, çmimi ishte përcaktuar jo në mënyrë përfundimtare, por ishte i përcaktueshëm, nga 75.000 euro në maksimum deri në jo më pak se 70 % të kësaj shume, në minimum.

2.1.10 Hartimi dhe nënshkrimi i deklaratës noteriale është në përputhje të plotë dhe përbën përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 2 të kontratës paraprake të shitjes me nr. (***) rep., nr. (***)kol., për përcaktimin përfundimtar të çmimit të shitjes.

2.1.11 Siç del edhe nga formulimi i përmbajtjes së dispozitave të vetë kontratës së kredisë, bëhet fjalë për financimin e një “*projekti*” që ka një kosto të përgjithshme prej 75.000 eurosh, duke iu referuar në këtë mënyrë kontratës paraprake të shitjes me nr. (***) rep., nr. (***)kol., e cila kishte parashikuar se çmimi përfundimtar i shitjes do të ishte i përcaktueshëm, jo më i lartë se 75.000 euro, por jo më i ulët se 70 % e kësaj shume.

2.2 Faktet nga hetimi administrativ për kredinë me kushte lehtësuese në “BKT”.

2.2.1 Në deklaratën “Vetting”, si burim për blerjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “(***)” subjekti deklaroi kredinë me kushte lehtësuese të marrë në “BKT”-ja sipas kontratës së kredisë bankare me nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 29.09.2011, mes “BKT”-së si kredihënës dhe Ervin Metallës si kredimarrës, në shumën 5.000.000 lekë, dhe dorëzanës E. M. e Xh. M.

2.2.2 Kjo kredi lidhet pas shtesës së kontratës kufi kredie me “Alpha Bank”, me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 11.04.2011, me anë të së cilës z. Ervin Metalla zëvendësohet si debitor ndaj “Alpha Bank” nga vëllai i tij, z. E. M.

2.2.3 Nga dokumentacioni i përcjellë nga Enti i Banesave, më datë 23.09.2014, ky ent i drejtohet Gjykatës së Lartë me kërkesë për plotësim dokumentacioni të munguar të dosjes së Ervin Metallës, si: kërkesën drejtuar titullarit për përfitim kredie; shkresën zyrtare nga Gjykata e Lartë drejtuar “BKT”-së për lidhjen e kontratës; certifikatën familjare dhe vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

2.2.4 Gjykata e Lartë, më datë 01.10.2014, i kërkon subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Metalla, plotësim dokumentacioni sipas shkresës së dërguar nga Enti Kombëtar i Banesave. Kërkesa

për plotësim dokumentacioni subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Metalla, i është dërguar nga ana e Entit Kombëtar të Banesave më datë 29.08.2014 edhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2.2.5 Nga dokumentacioni i përcjellë nga Enti Kombëtar i Banesave dhe “BKT”-ja rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla, më datë 18.04.2011 ka nënshkruar një deklaratë noteriale në lidhje me plotësimin e kushteve të parashikuara në vendimin nr. 600, datë 12.09.2007.

2.2.6 Për sa më sipër, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016.

- Duket se keni aplikuar në mënyrë të pasaktë dhe keni përfituar në mënyrë të parregullt një kredi e butë nga “BKT”-ja, në mospërmbushjen e kriterëve dhe kushteve ligjore për ta bërë një gjë të tillë.

- Kredia me kushte lehtësuese nga “BKT”-ja nuk mund të jetë burim krijimi për këtë pasuri, për sa kohë ajo është dhënë për të mundësuar banesë në vendin e punës (*në kohën e marrjes së kredisë, vendi i punës është Durrës*).

Sqarimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës ishin si vijon:

2.2.7 Në lidhje me faktin që kredia me kushte lehtësuese nga “BKT”-ja nuk mund të jetë burim krijimi për apartamentin e ndodhur në Tiranë, për sa kohë ajo është dhënë për banesë në vendin e punës (*vendi i punës, Durrës*), subjekti sqaroi se:

2.2.7.1 Është e vërtetë që banesa/apartamenti ku ai jeton sot e kësaj dite, që nga fillimi i vitit 2008, nuk pati burim krijimi këtë kredi, por aktualisht banesa ku jeton financohet nga kjo kredi me kushte lehtësuese, në rrethanat kohore dhe sipas mënyrës së shpjeguar në përgjigjet e pyetësorit të datës 02.03.2018.

2.2.7.2 Për lidhjen e kontratës së kredisë në kushte lehtësuese me “BKT”-në fillimisht ka shërbyer kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “(***)” sh.p.k., me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 30.06.2011, noter M. Rr., për porositjen e një apartamenti banimi në Durrës, ku punonte në atë kohë.

2.2.7.3 Megjithatë, në kohën që kredia ishte miratuar në parim nga “BKT”-ja, por ende nuk ishte disbursuar, nisur nga fakti që në korrik të vitit 2011 u zgjodh kryetar i Unionit të Gjuqtarëve të Shqipërisë, si dhe nisur nga fakti që në atë periudhë kishte angazhime të shtuara si ekspert në projekte të ndryshme, rreth fundit të muajit shtator 2011, vlerësoi që do të ishte e pamundur që t’u përgjigjej këtyre angazhimeve, nëse nuk do të vazhdonte të banonte në Tiranë.

2.2.7.4 Qëllimi i akordimit të kredisë me kushte të buta nuk ndjek ndonjë send të caktuar, por ka për mision lehtësimin e përmbushjes së nevojës për strehim të funksionarit të lartë publik.

2.2.7.5 Është e vërtetë që, në kohën e përfitimit të kredisë në kushte lehtësuese, vendi i punës ishte në qytetin e Durrësit, por duke iu referuar rrethanave specifike gjeografike, si p.sh., faktit se Durrësi është shumë afër me Tiranën, vetëm 39 km ose 30 minuta me makinë, nuk mund të konsiderohet se janë cenuar kriteret ligjore të përfitimit të një kredie të tillë. *Konstatimi do të ishte i drejtë nëse unë punoja në Korçë apo Sarandë, ndërsa apartamentin e financuar me kredi në kushte lehtësuese do ta kisha blerë në Tiranë.*

2.2.7.6 Plotësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore, në mënyrë përfundimtare, duhet të provohet dhe të ndodhë para se banka të miratojë kërkesën për kredi dhe të lidhë kontratën. Përcjellja e

emrit nga Gjykata e Lartë nuk do të thotë automatikisht plotësim i kushteve ligjore për përfitimin e kredisë në kushte lehtësuese dhe lidhje të menjëhershme të kontratës me bankën kredituese.

2.2.7.7 Kontrata me “BKT”-në është lidhur më datë 29.09.2011, ndërsa më datë 18.04.2011 subjekti i rivlerësimit kishte plotësuar, kundrejt përgjegjesisë përkatëse, deklaratën noteriale për plotësimin e kushteve ligjore për të përfituar kredi në kushte lehtësuese.

2.2.7.8 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se kopjet e printuara nga arkiva personale elektronike të kërkesave për kredi lehtësuese, drejtuar KLD-së, KM-së dhe për dijeni MD-së, përfaqësojnë të gjithë të vërtetën, lidhur me sa ai ka deklaruar.

2.3 Provat e administruara për vërtetimin e fakteve:

- Deklarata e pasurisë dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla, pranë ILDKPKI-së, më datë 25.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- Deklaratat e interesave private ndër vite, përpara fillimit të detyrës dhe ato periodike/vjetore dorëzuar pranë ILDKPKI-së në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe prova të depozituara nga subjekti i rivlerësimit fizikisht dhe në rrugë elektronike.
- Parashtrimet e tij në seancën dëgjimore të datës 18.07.2018 sipas procesverbalit të saj.
- Shkresë kthim-përgjigje, nr. (***) prot., datë 30.01.2018, OSHEE-së.
- Deklaratë noteriale me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.12.2007,
- Kontratë e kredisë me “Alpha Bank
- Kontrata paraprake e shitjes me nr. (***) rep., nr. (***) kol.
- Shtesë kontratë kufi kredie me “Alpha Bank”, me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 11.04.2011.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 15.01.2018, Gjykata e Rrethit Durrës.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 03.05.2018, nga Ministria e Drejtësisë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 08.02.2018, nr. (***) prot., datë 21.03.2018 KLD-së;
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 13.04.2018, nga Gjykata e Lartë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 12.2.2018, nga “BKT”-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 06.02.2018, nga Enti Kombëtar i Banesave.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 24.01.2018, nga “BKT”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 07.02.2018, Ministria e Energjisë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.01.2018, nga “Alpha Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.01.2018, nga “Alpha Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.01.2018, nga “Alpha Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.06.2018, nga “Alpha Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 27.04.2018, nga “BKT”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 27.4.2018, nga “BKT”.

2.4 Arsyetimi ligjor

2.4.1 Në lidhje me kredinë e marrë nga “Alfa Bank”, trupi gjyqesues arsyeton se:

2.4.1.1 Në përgjigje të pyetësorit të datës 2 mars 2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

(1) Oferta fillestare nga z. E. H. për apartamentin ka qenë afro 55.000 euro.

(2) Duke qenë se banka, në kushtet e kredisë së butë, nuk financonte më tepër se 70 % të vlerës së projektit dhe duke qenë se ai nuk kishte të ardhura të mjaftueshme për të financuar pjesën e mbetur, në nenin 2 të kontratës paraprake, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 18.07.2007, palët përcaktuan se çmimi i apartamentit do të ishte 75.000 euro dhe se do të ishte objekt negocimesh në kontratën definitive, por jo më pak se 70 % e çmimit.

(3) Pas marrjes së kredisë nga “Alpha Bank”, palët lidhën kontratën noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.12.2007, në të cilën përcaktuan çmimin prej 55.000 eurosh (*i barabartë me vlerën e kredisë që ishte miratuar dhe disbursuar më herët*).

2.4.1.2 Subjekti i rivlerësimit pranoi se çmimi i kontratës paraprake që u përdor për marrjen e kredisë u përfshi qëllimisht në vlerën prej 75.000 eurosh, në mënyrë që të mundësohej financimi i plotë i çmimit nga kredia (e butë) më vonë, kur ky çmim do të ndryshohej dhe do të binte në 55.000 euro - shumë kjo e barabartë me atë të kredisë.

2.4.1.3 Kjo tregon në mënyrë të qartë, - ashtu sikundër edhe vetë subjekti i rivlerësimit e ka thënë, - se pikërisht në momentin që u lidh kontrata paraprake e datës 18.07.2007, palët nuk e kishin qëllim ta zbatonin atë për sa i përket çmimit.

Përkundrazi, ata që në atë moment kanë pasur për qëllim që ta ndryshonin atë në 55.000 euro. Kjo kontratë paraprake e lidhur mes palëve është një veprim juridik që përbën një marrëveshje ndërmjet palëve, që nuk ka për qëllim të shkaktojë pasoja ligjore për sa i përket elementit kryesor të një kontrate shitblerjeje - çmimit. E vetmja pasojë që ka qenë synuar të arrihej nga palët ishte marrja e një kredie që do të mbulonte të gjithë çmimin dhe jo vetëm 70 % të tij.

2.4.2 Në lidhje me kredinë e marrë nga “BKT”-ja, trupi gjykues arsyeton se:

2.4.2.1 Kredia e butë e marrë nga “BKT”-ja nuk mund të jetë burim krijimi për apartamentin e banimit, me sip. 96.8 m² dhe garazhin, me sip. 22.5 m², të ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë, për sa më poshtë:

(i) Bazuar në nenin 2 të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, subjekteve të kësaj VKM-je, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës apo të funksionit shtetëror, kur kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim, me kredi, me kushte lehtësuese, nga shteti, për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës.

(ii) Në kuptim të këtij vendimi, vendi i punës nënkupton territorin e rrethit ku ndodhet selia administrative e organit ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën. Rezultoi e provuar se në kohën e marrjes së kredisë, vendi i punës së subjektit të rivlerësimit ishte në Durrës.

(iii) Bazuar në nenin 1 të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, ku përcaktohen të gjitha kategoritë e subjekteve që përfitojnë nga këto kredi, vërehet se në funksionin e kryetarit të Unionit të Gjyqtarëve apo të të qenët ekspert në angazhime të ndryshme. subjekti i rivlerësimit nuk mund të përfitojë kurrsesi nga këto kredi.

(iv) Subjekti i rivlerësimit, kur aplikoi për këtë kredi, nuk kishte hequr dorë as nga kredia në “Alfa Bank” dhe as nga apartamenti i banimit në Rr. “(***)”, Tiranë, pasja e të cilave përbënte kusht skualifikues për përfitimin e një kredie me kushte lehtësuese sipas germës “ç” të pikës 6 të VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007².

(v) Nisur nga fakti se vlerat monetare nga disbursimi i kredisë kanë kaluar në llogari të shoqërisë ndërtuese të apartamentit të vënë si objekt të marrjes së kredisë së butë, por i janë rikthyer pronarit faktik, subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet llogarisë së babait sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, brenda një afati kohor prej 2 ditësh, kredia e butë nuk është përdorur për qëllimin e përdorimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në kontratën përkatëse të kredisë.

² “ç) Nuk kanë në pronësi të tyre apo bashkëshortit/es pasuri të luajtshme, mjete motorike për qarkullim në tokë/det/ajër, likuiditete, tituj pronësie, përfshi edhe të drejta reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim.”

Më datë 28.12.2010, kur emri i subjektit të rivlerësimit ishte përcjellë nga Gjykata e Lartë për trajtim me kredi lehtësuese, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte hequr dorë as nga kredia në “Alpha Bank” dhe as nga apartamenti i banimit në Rr. “(***)”, Tiranë, pasi ai u zëvendësua në cilësinë e tij si debitor dhe si blerës nga z. E. M., me kontratat e datave 22.03.11 dhe 11.04.11.

Në deklaratën noteriale të datës 18.04.2011, subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur mbi përmbushjen e plotë të kushtit të parashikuar në germën “ç” - *nuk kanë në pronësi të tyre apo bashkëshortit/es pasuri të luajtshme, mjete motorike për qarkullim në tokë/det/ajër, likuiditete, tituj pronësie, përfshi edhe të drejta reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim*”

2.4.2.2 Subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet e provat e sjella nuk mundi të provojë me dokumentacion provues ligjor të kundërtën e barrës së provës dhe sa pretendohet nga ai, se ka pasur gjurmë të një korrespondence që daton para vitit 2009, lidhur me kërkesën e tij për të përfituar kredi me kushte lehtësuese.

2.4.2.3 Trupi gjykues vëren se nga ana e subjektit nuk është lexuar saktë dispozita ligjore kur arrihet në përfundimin se: *“Konstatimi juaj do të ishte i drejtë nëse unë punoja në Korçë apo Sarandë, ndërsa apartamentin e financuar me kredi në kushte lehtësuese do ta kisha blerë në Tiranë”*, ndërkohë që në dispozitën e cituar më sipër përcaktohet në mënyrë të qartë se cili konsiderohet vendi i ushtrimit të detyrës.

2.4.2.4 Me qëllim që të sigurohej përfitimi i kredisë lehtësuese, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar aneksin e kontratës paraprake të shitjes më datë 22.03.2011 për apartamentin ku banonte.

Neni 79 i Kodit Civil, parashikon se: *“Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”*.

Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 932, datë 22.06.2000, shprehet se: *“Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.”*

2.4.2.5 Aneks-kontrata paraprake e shitjes, më datë 22.03.2011, është një veprim fiktiv i simuluar, pa pasur qëllim krijimin e asnjë pasojë juridike bazuar në sa më poshtë:

- a) Subjekti i rivlerësimit ka pasur në posedim, pa ndërprerje, apartamentin nr. (***) , të ndodhur në Rr. “(***)”, Tiranë, që nga fillimi i vitit 2008, sipas deklarimit të bërë më datë 02.03.2018.
- b) Shkresa e OSHEE-së, nr. (***) , datë 05.07.2018, paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit, konfirmon se ndryshimi i emrit për kontratën e shpërndarjes së energjisë nga E. H. në Ervin Metalla është bërë në datën 14.10.2011, datë kjo kur subjekti i rivlerësimit ia kishte kaluar të drejtën për të fituar pronësinë mbi apartamentin nr. (***) vëllait të tij, me anë të kontratës së datës 22.03.2011.

- c) Në nenin 3 të aneks-kontratës paraprake të shitjes më datë 22.03.2011 përcaktohet se zëvendësimi i blerësit në kontratë, nga subjekti i rivlerësimit te vëllai i tij, bëhet pasi ky i fundit ka zëvendësuar të parin në cilësinë e debitorit ndaj “Alfa Bank”. Ndërsa zëvendësimi i debitorit është i një date të mëvonshme, pas lidhjes së kësaj aneks-kontrate (zëvendësimi i debitorit në “Alfa Bank” u krye me kontratën nr. (***)rep., nr. (***) kol.,nr. (***) , më datë 08.04.2011).

Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se provat e mësipërme konfirmojnë jo vetëm faktin e posedimit të pandërprerë të kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit, por dhe fiktivitetin e aneks-kontratës paraprake të shitjes, më datë 22.03.2011, lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij.

2.5 Baza ligjore

Bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, sipas nenit D, paragrafi 3, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, i Aneksit të Kushtetutës.

3. Kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “(***)” sh.p.k.

3.1 Faktet nga hetimi administrativ

3.1.1 Si objekt për kredinë e butë të marrë nga “BKT”-ja ka shërbyer kontrata e sipërmarrjes së ndërtimit me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 30 qershor 2011, mes firmës ndërtimore “(***)” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit dhe z. Ervin Metalla në cilësinë e porositesit, me objekt prenotimin e një apartamenti banimi në Durrës, me çmim 7.500.000 lekë.

3.1.2 Pas disbursimit të kësaj kredie të butë nga “BKT”-ja, në llogarinë e firmës “(***)” sh.p.k., në datën 25.10.2011, shuma prej 4.900.000 lekësh ka kaluar nga “BKT”-ja te shoqëria “(***)” sh.p.k. Në po të njëjtën datë, kjo shumë ka kaluar nga shoqëria “(***)” sh.p.k., me transfertë bankare, në llogarinë e shoqërisë “(***) Construction”.

3.1.3 Më datë 26.10.2011, një ditë më vonë, kjo shumë është rikthyer me transfertë bankare nga shoqëria “(***) Construction” te shoqëria “(***)” sh.p.k. Shoqëria “(***)” sh.p.k., më datë 27.10.2011, me kërkesë të porositesit Ervin Metalla, ia ka kaluar këtë shumë të përfituar nga kredia e butë me xhirim babait të subjektit të rivlerësimit, z. N. M., me përshkrim “*Kthim borxhi*”.

3.1.4 Shoqëria “(***)” sh.p.k., në përgjigjen e saj ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit të Parave, informon se: “*Më datë 30.06.2011, ndërmjet shoqërisë ‘(***)’ sh.p.k. dhe porositesit Ervin Metalla është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., pranë noterit M. Rr., për porositjen e blerjes së një apartamenti. Çmimi i blerjes, sipas kontratës, ishte në vlerën 7.500.000 lekë, që do të paguhej në dy këste. Kësti i parë, në vlerën prej 2.500.000 lekësh, është paguar në cash dhe kësti i dytë do të paguhej në momentin e disbursimit të kredisë që porositesi do të përfitonte nga ‘BKT’-ja.*

*Disa muaj pas lidhjes së kësaj kontrate, rreth fundit të muajit shtator 2011, në kohën që miratimit dhe disbursimi i kredisë për z. Ervin Metalla ishte në proces, shoqëria ‘(***)’ sh.p.k. ka rënë dakord në parim me mirëkuptim me porositesin Ervin Metalla për zgjidhjen e kontratës*

së sipërcituar të sipërmarrjes. Shuma prej 4.900.000 lekësh, me kërkesë të porositësit Ervin Metalla, është transferuar nga llogaria e shoqërisë së ndërtimit ‘(***)’ sh.p.k. në llogarinë e babait të tij, N. M., më datë 27.10.2011. Zgjidhja përfundimtare e kontratës së sipërmarrjes ndërmjet z. Ervin Metalla dhe shoqërisë “(***)” sh.p.k. u realizua më datë 23.04.2012, në kohën që shoqëria i ktheu porositësit Ervin Metalla pjesën e mbetur nga çmimi i parapaguar i tij, në shumën 2.500.000 lekë.”.

3.1.5 Iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit për mosdeklarim të likuiditeteve (në vlerë 4.900.000 lekë gjendje, më datë 31.12.2011), në pronësi faktike të subjektit të rivlerësimit në vitin 2011, si dhe për kontratën fiktive të lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë së ndërtimit “(***)” sh.p.k., për të përfituar nga trajtimi preferencial i kredisë së butë.

3.2 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi, si më poshtë:

3.2.1 Sipas subjektit, nëse kjo kontratë do të kishte qenë fiktive, ajo do të ishte zgjidhur menjëherë pas disbursimit të kredisë. Në fakt, kontrata u zgjidh përfundimisht më datë 23.04.2012, nëpërmjet aktit noterial (***), pas kthimit prej shoqërisë “(***)” sh.p.k. të kështit të parë në vlerën prej 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh të parapaguar prej meje që më datë 30.06.2011.

3.2.2 Nuk ka mosdeklarim të likuiditeteve (në vlerë 4.900.000 lekë gjendje, më datë 31.12.2011), në pronësi faktike në vitin 2011. Kjo shumë, në dukje likuiditet, nuk ka pasur këtë status juridik. Kjo shumë përbënte dhe vazhdon të përbëjë një detyrim ndaj “BKT”-së, si kredi/hua e marrë në kushte lehtësuese. Kjo shumë nuk përbënte likuiditet të lirë për t’u deklaruar si i tillë, edhe pse në pamje të parë duket ashtu. Destinacioni i saj ka qenë dhe mbetet financimi i apartamentit për strehim.

3.2.3 Kjo shumë u depozitua vetëm përkohësisht në llogarinë e babait, jo me qëllim për të shmangur detyrimin për ta deklaruar këtë shumë në deklaratën vjetore të vitit 2011, por për shkak të situatës ambige (*sui generis*) të krijuar në atë kohë: nga njëra anë, kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “(***)” sh.p.k. ishte në proces zgjidhje e sipër dhe, nga ana tjetër, ajo ende nuk ishte zgjidhur përfundimisht brenda vitit 2011, përderisa shoqëria “(***)” sh.p.k. nuk kishte kthyer ende kështin e parë të çmimit në vlerën prej 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh, të parapaguar më datë 30.06.2011.

3.4 Provat e administruara për vërtetimin e fakteve:

- Deklarata e pasurisë dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla pranë ILDKPK-së, më datë 25.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- Deklaratat e interesave private ndër vite, përpara fillimit të detyrës dhe ato periodike/vjetore dorëzuar pranë ILDKPKI-së në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe prova të depozituara nga subjekti i rivlerësimit fizikisht dhe në rrugë elektronike.
- Parashtrimet e tij në seancën dëgjimore të datës 18.07.2018, sipas procesverbalit.
- Kontratë sipërmarrjeje me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 30 qershor 2011, me firmën ndërtimore “(***)” sh.p.k.
- Deklaratë noteriale me nr. (***)rep, nr. (***)kol., datë 23.04.2012 (*noterit M. Rr.*), mes sipërmarrësit “(***)” sh.p.k. dhe porositësit Ervin Metalla.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 01.02.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

3.5 Arsyetimi ligjor

3.5.1 Neni 79 i Kodit Civil, parashikon se: “*Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile*”.

3.5.2 Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 932, datë 22.06.2000, shprehet se: “*Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.*”

3.5.3 Me qëllimin që të sigurohej përfitimi i kredisë lehtësuese, është lidhur kontrata e sipërmarrjes për apartamentin objekt kreditimi me firmën “(***)” sh.p.k., kontratë e cila është veprim fiktiv e i simuluar nga subjekti i rivlerësimit, pa pasur qëllim krijimin e asnjë pasoje juridike bazuar në sa më poshtë:

3.5.3.1 Palët nuk kanë pasur si qëllim kryerjen e këtij veprimi, por mbulimin e një veprim tjetër juridik (*nuk kanë pasur qëllim blerjen e apartamentit, por vetëm përfitimin nga kredia e butë*).

3.5.3.2 Prej kundërdeklarimit të firmës “(***)” sh.p.k., rezultoi se ka pasur një marrëveshje për zgjidhjen e kësaj kontrate sipërmarrjeje përpara se kredia e butë, që kishte objekt blerjen e këtij apartamenti, të disbursohej nga “BKT”-ja.

3.5.3.3 Transferimi i shumës së përfituar nga kredia e butë marrë nga “BKT”-ja që ditën e disbursimit, nga shoqëria “(***)” sh.p.k. te shoqëria “(***) Construction” sh.p.k., dhe më pas në llogari të babait të subjektit të rivlerësimit, provon mospërputhjen midis vullnetit të palëve dhe shfaqjes së tij, sipas dëshirës së vetë palëve të veprimit juridik.

3.5.3.4 Palët nuk kanë njoftuar bankën që kontrata e porosisë me shoqërinë “(***)” sh.p.k., për apartamentin objekt kreditimi me kredinë e butë, ishte rënë dakord të zgjidhej. Në këtë rast, palët duhet të tërhiqeshin nga kreditimi, pasi nuk ekzistonte më objekti i kreditimit.

Trupi gjykues arsyeton se:

(i) Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë se cila ishte arsyeja që shuma prej 4.900.000 (*katër milionë e nëntëqind mijë*) lekësh ishte depozituar në llogarinë bankare të babait, N.M., prej shoqërisë “(***)” sh.p.k., me kërkesë të tij, kur kontrata nuk ishte zgjidhur.

(ii) Deklarimi i subjektit të rivlerësimit se deklarimet e tij përputhen plotësisht me ato të shoqërisë “(***)” sh.p.k. nuk rezulton i saktë dhe i provuar, pasi subjekti i rivlerësimit, në asnjë rast nuk deklaroi faktin e deklaruar nga shoqëria “(***)” sh.p.k. “*se u ra dakord para disbursimit të kredisë për zgjidhjen e kontratës së porosisë*”. Subjekti i rivlerësimit, edhe pas barrës së provës deklaroi se kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “(***)” sh.p.k. ishte në proces zgjidhje e sipër gjatë vitit 2011, dhe u zgjidh përfundimisht në vitin 2012.

(iii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklarim të vlerave monetare që kanë qenë në pronësi faktike të tij, në fund të vitit 2011 (*në vlerë 4.900.000 lekë gjendje, më datë 31.12.2011*), sipas detyrimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, neni 4, pika “d” e tij.

(iv) Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se kjo shumë, në dukje likuiditet, nuk ka pasur këtë status juridik e nuk përbën likuiditet të lirë për t’u deklaruar si i tillë, është vetëm interpretim i

tij, që nuk përputhet me prova, fakte e me dispozitat ligjore dhe bie në kundërshtim me parashikimet ligjore të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

3.6 Baza ligjore

Bazuar në provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij sipas nenit D, paragrafi 1, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë vlerat monetare në pronësi të tij, sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.

4. Kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “(***) Construction” sh.p.k.

4.1 Faktet e hetimit administrativ

4.1.1 Kontrata e sipërmarrjes, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 31.12.2012, është lidhur mes shoqërisë ndërtuese “(***) Construction” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit, me objekt blerjen e një apartamenti 1+1, me sipërfaqe ndërtimore 96.43 m², kundrejt çmimit prej 7.500.000 lekësh.

4.1.2 Sipas kontratës së sipërmarrjes: *“Sipërmarrësi deklaron se ka marrë nga porositësi të gjithë shumën e sipërcituar të çmimit të shitjes para nënshkrimit të kësaj kontrate dhe nga palët deklarohet se nuk ka asnjë pretendim lidhur me çmimin e shitjes dhe mënyrën e pagesës”.*

4.1.3 Shoqëria “(***) Construction” sh.p.k. depoziton pranë Komisionit dy mandatarkëtime, përkatësisht mandatarkëtim nr. 77, datë 23.04.2012, në vlerë 5.000.000 lekë, me përshkrimin (*E. Metalla, këst për apartament në Rr. “(***)”*) dhe mandatarkëtimin nr. 127, datë 20.12.2012, në vlerë 2.500.000 lekë, me përshkrimin (*E. Metalla, këst i fundit për apartament në Rr. “(***)”*).

4.1.4 Nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar (nga faqja zyrtare e QKB-së) për shoqërinë “(***) Construction” sh.p.k., me NUIS (***) , me vendimin e datës 01.11.2012 është vendosur pushim i përkohshëm i aktivitetit të kësaj kompanie.

4.1.5 Shoqëria “(***) Construction” sh.p.k., në periudhën që ka qenë me aktivitet të pezulluar (që prej datës 01.11.2012), ka nënshkruar kontratë sipërmarrjeje dhe ka lëshuar mandatarkëtim me subjektin e rivlerësimit (datë 31.12.2012).

4.1.6 Shoqëria “(***) Construction” sh.p.k., në përgjigjen dërguar Komisionit më datë 30.03.2018, ka theksuar faktin se: *“Fatura tatimore nuk disponojmë. Në përgjigjet e mëparshme kemi dërguar një kopje të mandateve që vërtetojnë pagimin e kësteve nga porositësi E. M. Mandatarkëtimi i sipërcituar është fakt që dokumenton pagesën e vlerës prej 5.000.000 lekësh, të paguara nga E. Metalla”.*

4.1.7 Referuar aktmarrëveshjes së datës 20.04.2012 (paraqitur në dokumentacionin shoqëruar të pyetësorit të datës 02.03.2018), e cila ka për palë: Huadhënësin B. G., huamarrësin B. K., si dhe ceduesit E. M. dhe N. M.. Në nenin 2 të aktmarrëveshjes përcakton se: *“...qëllimi i kësaj aktmarrëveshjeje është që huadhënësi B. G. të konsiderojë të shlyer huan në shumën 5.000.000*

*lekë, prej huamarrësit B. K., me kushtin që ky i fundit të pranojë si të paguar prej ceduesit/porositësit E. Metalla të kështit të parë në të njëjtën vlerë të çmimit të apartamentit që po ndërtohet nga shoqëria sipërmarrëse “(***)Construction” sh.p.k”.*

4.1.8 Për sa më sipër, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me mospërputhjet për mënyrën e pagesës së kësteve të këtij apartamenti; mungesën e kontratës paraprake të sipërmarrjes, datë 23.04.2012, të lidhur me firmën “(***) Construction” sh.p.k.; kontrata paraprake e sipërmarrjes, nuk është depozituar në dosje dhe nuk është deklaruar në vitin 2012 nga subjekti i rivlerësimit në asnjë deklaram periodik duke nisur që nga ai i vitit 2012; si dhe ka deklarime kontradiktore për vërtetësinë dhe ligjshmërinë e këtij transaksioni në vitin 2012.

4.1.9 Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës:

4.1.9.1 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me shkresën nr. (***)prot., datë 10.05.2017, drejtuar ILDKPKI-së, e cila gjendet në dosjen e rivlerësimit, ndër të tjera, konfirmon likuidimin e çmimit në vlerën prej 7.500.000 lekësh për blerjen e apartamentit.

4.1.9.2 Statusi i pezulluar i shoqërisë “(***) Construction” sh.p.k. nuk kishte ndikim tek e drejta e tij apo te detyrimi që po merrte përsipër shoqëria e pezulluar.

4.1.9.3 Marrëveshja e datës 23.04.2012 me shoqërinë “(***) Construction” sh.p.k., - e titulluar kontratë paraprake sipërmarrjeje/porosie, - kishte për qëllim dokumentimin e nisjes së krijimit të një marrëdhënieje juridike ndërmjet palëve dhe, veçanërisht, pagimit të kështit të parë në vlerën prej 5.000.000 lekësh të çmimit të porosisë/blerjes, për të cilin shoqëria lëshoi mandatin përkatës vërtetues, sipas parashikimit të palëve në marrëveshjen e datës 20.04.2012.

4.1.9.4 Është e vërtetë që kontrata paraprake e sipërmarrjes, datë 23.04.2012, e lidhur me firmën “(***) Construction” sh.p.k. nuk është depozituar në dosje dhe nuk është deklaruar në vitin 2012 dhe në asnjë deklaram periodik, por kjo nuk ka qenë as e nevojshme dhe as e detyrueshme.

4.1.9.5 Nuk ka bazë që të duket se ka deklarime kontradiktore për vërtetësinë dhe ligjshmërinë e këtij transaksioni në vitin 2012. Vërtetësia e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit mbështetet edhe në aktet që gjenden në dosjen e rivlerësimit

4.2 Provat e administruara për vërtetimin e fakteve:

- Deklarata e pasurisë dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së.
- Deklaratat e interesave private ndër vite, dokumentacioni i dorëzuar përpara fillimit të detyrës dhe periodik/vjetor dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe prova të depozituara nga subjekti i rivlerësimit fizikisht dhe në rrugë elektronike.
- Parashtrimet e subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 18.07.2018 sipas procesverbalit.
- Shkresë kthim përgjigje, datë 15.01.2018, nga shoqëria “(***) Construction” sh.p.k.
- Shkresë kthim përgjigje nga shoqëria “(***) Construction” sh.p.k., me nr. (***)prot., datë 30.03.2018.

- Shkresë kthim përgjigje nga shoqëria “(***) Construction” sh.p.k., me nr. (***)prot., datë 22.05.2018.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.04.2018, nga QKB-ja.
- Shkresë nr. (***)prot., datë 01.02.2018, nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- Kontratë sipërmarrjeje me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 31.12.2012, noter J. Zh.
- Shkresë kthim përgjigje, datë 19.02.2018, nga noteri I. H.
- Kopje të mandatpagesës, datë 23.04.2012, të lëshuar nga shoqëria, që vërteton pagimin e këstit të parë të çmimit në shumën 5.000.000 lekë nga z. Ervin Metalla te shoqëria “(***) Construction”.
- Kopje të mandatpagesës, datë 20.12.2012, të lëshuar nga shoqëria që vërteton pagimin e këstit të dytë të çmimit, në shumën 2.500 000 lekë, nga z. Ervin Metalla te shoqëria “(***) Construction”.
- Aktmarrëveshje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 20.12.2013, te notere F. K., ndërmjet Ervin Metallës dhe E. M., si dhe shoqërisë “(***) Construction” sh.p.k, si dhënese e pëlqimit për kalimin e të drejtave.
- Ekstrakt historik i regjistrit tregtar (nga faqja zyrtare e QKB-së) për shoqërinë “(***) Construction” sh.p.k., me NUIS (***)).
- Shkresë nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave me nr. (***)prot., datë 10.05.2017, drejtuar ILDKPI-së.
- Aktmarrëveshje e datës 20.04.2012 (*paraqitur në dokumentacionin shoqërues të pyetësorit të datës 02.03.2018*), e cila ka për palë: Huadhënësin B. G., huamarrësin B. K., si dhe ceduesit E. M. dhe N. M.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 27.04.2018, nga “BKT”-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 27.4.2018, nga “BKT”-ja.

4.3 Analiza e provave

4.3.1 Trupi gjykues arsyeton se kontrata paraprake e sipërmarrjes, më datë 23.04.2012, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit me firmën “(***) Construction” sh.p.k:

- (i) nuk është depozituar në dosje e nuk është deklaruar në vitin 2012 dhe në asnjë deklaram periodik;
- (ii) mandatet që shoqërojnë këtë kontratë për pagesën e kësteve, lëshuar nga shoqëria “(***) Construction” sh.p.k., konfirmuar me shkresën e kësaj shoqërie “Kthim përgjigje” protokolluar pranë Komisionit, me shkresë nr. (***), datë 30.03.2018, nuk janë mandate që të përputhen me mënyrën e shlyerjes së pagesës dhe me shlyerjen reale të detyrimit;
- (iii) kontrata e shitblerjes, e bazuar në këtë kontratë sipërmarrjeje, është lidhur në kohën kur shoqëria ka qenë e pezulluar.

4.3.2 Trupi gjykues arsyeton se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, - se Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka konfirmuar likuidimin e çmimit në vlerën prej 7.500.000 lekësh për blerjen e apartamentit, - është i pasaktë, pasi kjo drejtori ka konfirmuar vetëm kryerjen e veprimit të blerjes së kësaj pasurie nga noteri, sepse në përputhje me legjislacionin në fuqi në vitin 2012, kohë kur është kryer veprimi juridik, ka pasur rregullim specifik për lëvizjet monetare midis personave fizikë te noteri, nëpërmjet Udhëzimit nr. 6915/2, datë 30.01.2012, “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit”, “Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 183, dhjetor 2012, botuar më datë 17.01.2013 dhe, në këtë mënyrë, që të provohej likuidimi i çmimit pas janarit të vitit 2012, do të duhej të provohej

kalimi i çmimit të paguar në llogarinë e noterit sipas detyrimit ligjor të parashikuar më sipër, në kohën e kryerjes së veprimit të blerjes së kësaj pasurie.

4.3.3 Mandatpagesa e datës 20.12.2012, e lëshuar nga shoqëria që vërteton pagimin e kështit të dytë të çmimit, në shumën 2.500.000 lekë, nga z. Ervin Metalla te shoqëria "(***) Construction" sh.p.k.

4.3.4 Trupi gjykues arsyeton se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, se vetë shoqëria "(***) Construction" sh.p.k. konfirmon sa më sipër mbështetur në dokumente shkresore me fuqi të plotë provuese, qoftë akte noteriale, e qoftë shkresa private, përmbajtja e të cilave lidhet dhe konfirmon njëra-tjetrën, nuk është i vërtetë, pasi dokumentacioni i depozituar nga shoqëria "(***) Construction" sh.p.k. jo vetëm është kontradiktor, por është edhe jo në përputhje me faktet reale, siç u analizua më lart.

4.4. Baza ligjore

Trupi gjykues, bazuar në provat e faktet e analizuara së bashku, arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (ii) Ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasurinë. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm.

5. Pasuria e personit tjetër të lidhur.

5.1 Faktet nga hetimi administrativ:

5.1.1 Bazuar në nenin 32/4, kreu IV "Vlerësimi i pasurisë", dhe në nenin 3/14 të ligjit nr. 84/2016, vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. E. M.:

- Zëvendëson subjektin e rivlerësimit si debitor për kredinë e marrë në "Alpha Bank", duke marrë përsipër pagimin e saj;

- Zëvendëson subjektin e rivlerësimit si blerës i apartamentit në Rr. "(***)" dhe mbas këtij veprimi, në apartamentin ku ai ishte blerësi, ka vijuar banimin subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla;

- I paguan subjektit të rivlerësimit shumën për cedimin e kredisë në "Alpha Bank";

- Vendors kolateral shtëpinë e tij për kredinë e butë të marrë nga subjekti i rivlerësimit pranë "BKT"-së.

5.1.2 Nga hetimi i Komisionit, rezultoi se shtetasi E. M. ka në pronësi pasuritë si më poshtë:

1) Apartament me nr. pasurie (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***), me sip. 55.8 m², blerë me kontratë shitblerjeje, viti 2008, në vlerën 44.000 euro.

2) Apartament me nr. pasurie (***), ZK (***), me nr. hipotekor (***), me sip. 67.5 m², blerë me kontratë paraprake shitjeje, viti 2008, në vlerën 13.500 euro,

Gjithashtu subjekti i rivlerësimit, ka qarkulluar vlera monetare, konkretisht:

3) Për periudhën 2012 - 2013, ka investuar në bono thesari të BSH-së, vlerat 10.000.000 lekë; 3.010.000 lekë depozituar në "ICB"; dhe 50.000 euro të dhëna hua shoqërisë "(***) Construction" sh.p.k.

4) Për periudhën 2013 - 2014 investuar në bono thesari të BSH vlerat 10.000.000 lekë; 5.000.000 lekë të depozituara në "ICB";

5) Për periudhën 2014 - 2015, investuar në bono thesari të BSH-së në vlerën 15.000.000 lekë, ndërkohë që është shitur autovetura në vlerën prej 1.200.000 lekësh (datë 12.11.2014).

6) Për periudhën 2015 - 2016, investuar në bono thesari të BSH-së në vlerën 12.000.000 lekë, transferim për vëllanë E. M. vlerën prej 2.000.000 lekësh, si dhe depozitë me afat në “BKT”, vlerën 10.000 euro, më datë 24.12.2015.

7) Më datë 02.08.2017 ka kaluar në depozitë me afat në llogarinë e tij në “BKT” vlerën prej 101.340 eurosh.

5.1.3 Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, datë 10.05.2018 (nëpërmjet formës elektronike), periudhat e krijimit të të ardhurave të vëllait janë dy, konkretisht:

- Të ardhura të krijuara nga emigracioni në Itali për periudhën 1997 – 2008; dhe

- Të ardhura nga zhvillimi i një aktiviteti së bashku me shokun e tij, z. B. R., e më pas duke filluar nga mesi i vitit 2009, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse i vetëm, si dhe fitimet si ortak (bashkëlidhur prokurën e përgjithshme nr. (***) datë 31.07.2009).

5.1.4 Referuar shkresës, nr. (***) prot., datë 23.04.2018, të ardhurat e realizuara nga punësimi për z. E. M., në subjektin B. R., person fizik, për periudhën janar 2012 - dhjetor 2017, janë si më poshtë:

Periudha	Paga bruto /vit	Ndalesa	Paga neto/vit
2012	300.000	51.600	248.400
2013	300.000	38.100	261.900
2014	300.000	33.600	266.400
2015	300.000	33.600	266.400
2016	265.000	29.680	235.320
2017	59.000	6.608	52.392
Totali	1.524.000	193.188	1.330.812

5.1.5 Referuar të ardhurave nga aktiviteti i subjektit B. R., person fizik, sipas të dhënave të shkresës nr. (***) prot., datë 14.05.2018, të DRT-së Durrës, për periudhën 2008 – 2016, është deklaruar një fitim fiskal në vlerën prej 4.287.898 lekësh, dhe fitim i llogaritur në vlerë 1.669.170 lekë.

Periudha	Të ardhura	Shpenzime	Fitim i llogaritur	Fitim fiskal DRTD
2008	2.605.930	2.058.504	547.426	547.426
2009	2.878.200	2.168.074	710.126	710.126
2010	2.999.950	2.302.750	697.200	697.200
2011	5.408.534	5.058.497	350.037	737.226
2012	3.572.727	3.675.709	-102.982	490.507
2013	2.485.693	2.946.658	-460.965	237.085
2014	2.976.726	2.436.726	540.000	540.000
2015	6.602.653	7.254.714	-652.061	287.939
2016	5.117.555	5.077.166	40.389	40.389
Totali	34.647.968	32.978.798	1.669.170	4.287.898

5.1.6 Sa më sipër, iu kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës për të dorëzuar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, vëllait të tij, z. E. M.

5.1.7 Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla, solli shpjegimet e kërkesat si vijon:

5.1.7.1 Subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues revokimin e vendimit të ndërmjetëm të Komisionit për të konsideruar vëllain, z. E. M., si *person tjetër të lidhur*, si dhe çlirimin e tij nga barra për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të vëllait të tij, bazuar në nenin 3/14 të ligjit nr. 84/2016, duke theksuar se ILDKPKI-ja, në asnjë rast, nuk e ka cilësuar vëllain, z. E. M., si person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

5.1.7.2 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se pasuritë e paluajtshme në pronësi të vëllait të tij, z. E. M. apartamenti, me nr. pasurie (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***), me sip. 55.8 m² dhe apartament me nr. pasurie (***), ZK (***), me nr. hipotekor (***), me sip. 67.5 m², janë blerë me kontratë në vitin 2008, kohë e cila përkon me kthimin e tij nga emigracioni ekonomik në Itali dhe si burim për krijimin e këtyre pasurive janë të ardhurat e përfutuara nga emigracioni ekonomik për një periudhë gati 10-vjeçare në Itali.

5.1.7.3 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se cilësia e vëllait si emigrant ekonomik në Itali është provuar nëpërmjet dërgimit të kopjes së lejes së rregullt të qëndrimit të tij (*Permesso di Soggiorno per Stranieri*) me nr. (***), më datë 27.06.2001, leje e cila është rinovuar përsëri më datë 28.06.2005.

5.1.7.4 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se vëllai i tij, z. E. M., nuk ka pasur detyrimin dhe as ka mundur të ruajë dokumentacion tjetër lidhur me qëndrimin, punësimin apo të ardhurat e tij në shtetin italian për këtë periudhë, pothuaj 10-vjeçare, duke qenë se edhe ka kaluar një kohë e gjatë që prej zhvendosjes së rezidencës së tij në Shqipëri.

5.1.7.5 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se pasuritë e luajtshme në pronësi të vëllait, z. E. M., duke filluar që nga viti 2012 (*investuar në bono thesari, depozita etj.*), të cilat në vitin 2017 rezultojnë në total në shumën 101.340 euro, burimi i krijimit të tyre, janë pjesërisht kursimet nga emigracioni në Itali dhe pjesërisht të ardhurat nga biznesi privat “Galeri arti (*shitje pikturash*), bar-kafe”, zhvilluar në objektin “(***), Durrës, si dhe të ardhura nga qiraja, interesa nga huaja, interesa nga bonot e thesarit dhe depozita.

5.1.7.6 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se për të ardhurat e vëllait nga zhvillimi i një aktiviteti të deklaruar së bashku me shokun e tij, z. B. Ra., nga mesi i vitit 2009, vëllai ka pasur të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse si dhe fitimet si ortak me prokurë.

5.2 Provat për vërtetimin e fakteve

- Deklarata e pasurisë dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla, pranë ILDKPKI-së, më datë 25.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- Deklaratat e interesave private ndër vite, përpara fillimit të detyrës dhe ato periodike/vjetore dorëzuar pranë ILDKPKI-së në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
- Përgjigjet e pyetësorëve dhe prova të depozituara nga subjekti fizikisht dhe në rrugë elektronike.
- Parashtrimet e subjektit në seancën dëgjimore të datës 18.07.2018, sipas procesverbalit.
- Aneks-kontratë paraprake shitjeje, nr. (***), kol., nr. (***) rep., datë 22.03.2011, notere Dh. Q.

- Kontratë nr. (***) kol., nr. (***) rep., datë 11.04.2011, për ndryshimin e kontratës për kufirin e kredisë te notere Dh. Q.
- Akt-marrëveshje me nr. (***) kol., nr. (***) rep., datë 20.12.2013, mes palëve Ervin Metalla dhe E. M, dhe dhënësi i pëlqimit (***) sh.p.k., notere F. T. K.
- Kontratë shitblerjeje pasuri e luajtshme, nr. (***) kol., nr. (***) rep., datë 12.11.2014.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 08.02.2018, nga ZVRPP-ja Tiranë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 29.12.2017, nga ZVRPP-ja Tiranë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 30.01.2018, nga OSHEE-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. 2(***) prot., datë 28.02.2018, nga OSHEE-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 11.05.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Durrës.
- Vërtetimi i Njesisë Administrative Nr. (***), Bashkia Tiranë, datë 03.07.2018.
- Certifikatë familjare e kryefamiljarit E. M, lëshuar më datë 06.07.2018, nga Zyra e Gjendjes Civile e Njesisë Administrative Nr. (***), të Bashkia Tiranë.
- Shkresë studios ligjore italiane, “(***)”, e datës 02.07.2018.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 20.04.2018, nga ALUIZNI.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 23.04.2018, nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Tiranë.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 14.05.2018, nga Drejtoria Rajonale Tatimeve Durrës.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 26.04.2018, noter J. Zh.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 22.05.2018, shoqëria “(***)” sh.p.k.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 27.04.2018, nga “BKT”-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 27.04.2018 nga “BKT”-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 16.04.2018, nga “ICB”-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 18.04.2018, nga “ICB”-ja.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 16.04.2018, nga “Raiffeisen Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 16.04.2018, nga “Union Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.01.2018, nga “Alpha Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 25.06.2018, nga “Alpha Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***)prot, datë 18.04.2018, nga “ProCredit Bank”.
- Shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 17.04.2018, nga “Fibank”

Trupi gjykues i konsideroi të panevojshme marrjen e dëshmive të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, të z. N. D e znj. B. D, banues në Rr. “(***)”, pall. “(***)”, ap. (***) , Tiranë, pasi vlerësoi si të panevojshme marrjen e këtyre dëshmive për këtë pikë të rezultateve të hetimit.

5.3 Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues arsyeton se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për revokim të vendimit për të konsideruar person të lidhur vëllain e subjektit të rivlerësimit është e pabazuar në ligj e prova:

5.3.1 Z. E. M plotëson kriteret e nenit 3, pika 14, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë e juridikë, që duket se kanë apo kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

5.3.2 Z. E. M plotëson kriteret e nenit 32, pika 4, sipas të cilit personat e tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këtë marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

5.3.3 Sipas deklarimeve vjetore të ndryshme të subjektit të rivlerësimit dhe sqarimeve të tij, edhe gjatë kohës që vëllai zëvendësonte subjektin e rivlerësimit në kredinë e tij dhe në blerjen

e apartamentit të ndodhur në Rr. (***) , subjekti i rivlerësimit ka vazhduar të banonte në po atë apartament, çka shkakton detyrimisht përdorim dhe marrëdhënie huadhënësi-huamarrësi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij, z. E. M.

5.3.4 Periudha kohore gjatë së cilës shtrihet marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit fillon nga zëvendësimi i subjektit të rivlerësimit si debitor për kredinë e marrë në “Alpha Bank”, duke marrë përsipër pagimin e saj prandaj është detyrim i subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur të justifikojë burimin legjitim të krijimit të pasurive të personit tjetër të lidhur, vëllait të tij z. E. M që nga kjo periudhë.

5.3.5 Trupi gjykues arsyeton se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, se ILDKPKI-ja në asnjë rast nuk e ka cilësuar vëllain E. M si person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit, bëhet duke mos mbajtur parasysh vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilave Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kryen hetim të gjithanshëm dhe të pavarur, pavarësisht hetimit të kryer nga institucionet e tjera.

5.3.6 Trupi gjykues arsyeton se, lidhur me pasuritë e luajtshme në pronësi të vëllait E.M., duke filluar që nga viti 2012 (*investuar në bono thesari, depozita etj.*), të cilat në vitin 2017 rezultojnë në total në shumën prej 101.340 eurosh, burimi i krijimit të tyre, sipas vëllait E. M, janë pjesërisht kursimet nga emigracioni në Itali dhe pjesërisht të ardhurat nga biznesi privat “Galeri arti”.

5.3.6.1 Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për pasuritë në pronësi të vëllait E. M, se burimi për krijimin e këtyre pasurive janë të ardhurat e përfutuara nga emigracioni ekonomik për një periudhë gati 10-vjeçare në Itali, provuar nëpërmjet dërgimit të kopjes së lejes së rregullt të qëndrimit të tij, - bie ndesh me sa rezultoi nga hetimi administrativ, ku sipas të dhënave të sistemit TIMS, vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. E. M, për periudhën 2004 - 2017 ka kryer lëvizje të pakta (*gjithsej 14*) me qëndrim të shkurtra, me destinacion Italinë, duke rrëzuar pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit se vëllai i tij ka qenë me rezident permanent dhe i punësuar me kohë të plotë në Itali, për periudhën 2004 -2008.

5.3.6.2 Përveç sa u argumentua më lart për të ardhurat nga emigracioni bazuar në të dhënat të shkresës nr. (***)prot., datë 14.05.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, për periudhën 2008 - 2016 nga subjekti tregtar B. R person fizik, është deklaruar një fitim fiskal prej 4.287.898 lekësh, dhe fitim i llogaritur në vlerë 1.669.170 lekë. Prandaj, të ardhurat e provuara me dokumentacion provues ligjor, nuk justifikojnë pasuritë dhe vlerat monetare në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. E. M.

5.3.7.Trupi gjykues arsyeton se, sa u takon fitimeve nga biznesi privat në Shqipëri, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se fitimi ka qenë më i lartë nga ai i konstatuar, nuk është i mbështetur në ligj dhe në prova.

5.3.8 Trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë burimin e ligjshëm të krijimit për pasuritë e vëllait të tij: pasuri të paluajtshme, si dhe llogaritë bankare të krijuara në vite nga vëllai i tij, duke mos depozituar dokumentacion provues ligjor për të ardhurat e ligjshme të vëllait të tij nga emigracioni në shtetin italian, si dhe duke mos provuar me dokumentacion provues ligjor të ardhurat nga aktiviteti tregtar i biznesit “Galeri arti”, në Durrës.

5.3.9 Trupi gjykues vlerëson se shkresa e studios ligjore italiane, “(***)”, e datës 02.07.2018, aplikim i z. E. M, për të siguruar dokumentacionin e të ardhurave të tij në shtetin italian, nuk përmbush parashikimet e nenit 32/2 për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave.

5.3.10 Trupi gjykues arsyeton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se ky detyrim për të provuar me dokumentacion provues ligjor ligjshmërinë e krijimit të pasurive të vëllait cenon parimin e proporcionalitetit, është i pabazuar në ligj, për sa kohë vëllai plotëson kushtet ligjore për t’u konsideruar person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit.

Trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë burimin e ligjshëm të krijimit për pasuritë e vëllait të tij, pasuri të paluajtshme, si dhe llogaritë bankare të krijuara në vite nga vëllai i tij, duke mos depozituar dokumentacion ligjor për të ardhurat e ligjshme të vëllait.

5.4 Baza ligjore

Bazuar në provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur sipas nenit D, paragrafi 1, të Aneksit të Kushtetutës.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave të personit tjetër të lidhur bazuar në nenin 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.
- (iii) Në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se në tërësi, subjekti i rivlerësimit, bazuar në provat që disponon Komisioni e në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait të tij, sipas parashikimeve të nenit D, paragrafi 3, të Aneksit të Kushtetutës.
- (iv) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (v) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

6. Përfaqësimi në GjEDNj sipas prokurës së posaçme.

6.1 Faktet nga hetimi administrativ

6.1.1 Në periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka qenë gjithashtu përfaqësues me prokurë të posaçme të të afërmit e tij për ndjekjen e çështjes në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, deri në ekzekutimin e vendimit nga autoritetet vendëse brenda shtetit shqiptar.

6.1.2 Në lidhje me këtë fakt, iu kalua barra e provës subjektit të rivlerësimit nëse në kohën e pajisjes më këtë prokurë, ai ka vepruar:

- Në kundërshtim me nenin 96, germa “ç”, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se “*Gjyqtarët dhe prokurorët nuk mund të jenë përfaqësues të palëve*”;
- Në kundërshtim me nenin 143 të Kushtetutës (*referuar dispozitës kushtetuese në fuqi në atë periudhë*), i cili parashikon se: “*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private*”;
- Në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Në kundërshtim me vendimin nr. 44, datë 07.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

6.2 Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës:

6.2.1 Prokura me nr. (***), datë 28.04.2011, pavarësisht se, ndër të tjera, përmban edhe autorizimin për ndjekjen e “*Të gjitha procedurave administrative dhe gjyqësore*”, nuk ka ofruar këshillim apo përfaqësim të drejtpërdrejtë të familjes, në asnjë gjykatë kombëtare apo ndërkombëtare; detyra e tij ka qenë të gjejë një avokat, të vëzhgojë punën e tij në vijimësi, për të informuar pronarët, si dhe të ishte përfaqësues i pronarëve në raport me të; si përfaqësues i familjes pronare nuk është paguar ndonjëherë për këtë gjë; shpërblimi i akorduar nga GjEDNj-ja në Strasburg u ekzekutua nga qeveria shqiptare dhe u kreditua vetëm përkohësisht përmes llogarisë së tij, pasi shumë shpejt ia kaloi atë tërësisht pronarëve.

6.2.2 Shprehja standard “Për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe gjyqësore”, formulim i cili gjendet rëndom dhe është i përhapur në të gjitha prokurat në përgjithësi, i atribuohet avokatit E. M, i cili ka mbajtur korrespondencën me GjEDNj-në, duke qenë se bëhet fjalë për një gjykim mbi aktet në këtë rast.

6.2.3 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se autorizimi me prokurë nga familjarët, sikurse ka ndodhur në rastin konkret, nuk parashikohet si ndalim nga asnjë dispozitë kushtetuese apo ligjore. Ai nuk ka shkelur në asnjë moment nenin 143 të Kushtetutës, pasi për asnjë moment të jetës, duke qenë gjyqtar, nuk ka ushtruar veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private.

6.3 Provat për vërtetimin e fakteve:

- Deklaratat e pasurisë dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla, pranë ILDKPKI-së, më datë 25.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Deklaratat e interesave private ndër vite, përpara fillimit të detyrës dhe ato periodike/vjetore dorëzuar pranë ILDKPKI-së në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe ndryshimet e tij.
- Përgjigjet e pyetësorit dhe dokumentacioni shoqërues, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla, më datë 02.03.2018, fizikisht dhe në rrugë elektronike, si dhe pyetje përgjigjet shpesh.
- Parashtrimet e subjektit dhe kopje të provave shkresore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në rrugë elektronike dhe fizikisht më datë 09.07.2018, si dhe parashtrimet e tij në seancën dëgjimore të datës 18.07.2018 sipas procesverbalit të saj.
- Prokurorë e posaçme nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 28.04.2011.
- Korrespondenca e GjEDNj-së me avokatin E. M.

6.4 Arsyetimi ligjor

Trupi gjykues arsyeton se shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit ishin bindëse e të plota. Ai provoi se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nuk ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e legjisllacionit shqiptar duke mos qenë në kushtet e konfliktit të interesit midis detyrës së tij dhe interesave private.

6.5 Baza ligjore

Bazuar në nenin 52/2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, me provat e shpjegimet e paraqitura, arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

7. Gjatë hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime edhe për mungesën e deklarimit në deklaratën vjetore të vitit 2006 të shitjes së makinës me nr. targe (***) dhe për burimet e krijimit të apartamentit në vlerën prej 40.000 eurosh, blerë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në (***), pas deklaratës “Vetting”.

Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit ishin të plota në lidhje me sa më sipër, dhe i konsideron ato të mjaftueshme.

Në vlerësim tërësor të procedurave për vlerësimin e pasurisë trupi gjykues arsyeton se Subjekti i rivlerësimit, për qëllim përfitimi financiar, ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive të simuluar, të cilat nuk përputhen me sjelljet etike që një gjyqtar prit të ketë:

(i)Kontrata paraprake nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 18.07.2007, është lidhur duke mos pasur qëllim të sillte pasoja juridike në lidhje me elementin kryesor të një kontrate shitjeje, çmimin, por me qëllim për të përftuar një kredi nga “Alpha Bank” që do të mbulonte të gjithë çmimin e apartamentit që synohej të blihej, dhe jo thjesht 70 % të vlerës së tij.

(ii)Kontrata midis subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur me të, vëllait, ku ky i fundit zëvendëson subjektin e rivlerësimit në blerjen e apartamentit në Rr. “(***)” dhe në kredinë nga “Alpha Bank” është lidhur pa qëllim real për t’u përmbushur, por për të bërë që subjekti i rivlerësimit të dukej se formalisht i përmbushte kriteret për të përftuar një kredi të butë.

(iii)Kontrata fiktive me shoqërinë “(***)” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti në Durrës, është lidhur për të përftuar shumën 4.900.000 lekë, nga kredia e butë e “BKT”-së, pa qëllim për ta përmbushur atë. Në fakt, siç dëshmojnë veprimet e mëpasshme të tërheqjes nga kontrata dhe fillimi i një marrëdhënieje me shoqërinë “(***)” sh.p.k. për një apartament në Tiranë, subjekti i rivlerësimit synonte që, me shumën e përftuar nga kredia e butë, të blinte një apartament në Tiranë. Kredia e butë marrë nga subjekti i rivlerësimit në “BKT”-në nuk është përdorur për qëllimin mbi të cilin është marrë dhe nga dosja nuk rezulton që banka të ketë qenë e informuar për këtë përdorim të huas përtej projektit thelb të kontratës.

Jeta personale e gjyqtarëve, sjellja e tyre jashtëgjyqësore, është po aq e rëndësishme sa ajo në kontekstin profesional. Standarde të sjelljes etike të gjyqtarëve janë shtjelluar shterueshëm dhe vazhdojnë të shtjellohen nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Siç shtjellon jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me paanësinë, në “Teorinë e dukjes”, standardet e etikës zbatohen edhe jashtë gjykatës dhe përfshijnë jetën private, duke kërkuar që gjyqtarët të sillen me integritet dhe në një mënyrë të denjë për detyrën.

Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Metalla, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Në zbatim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës ndaj tij zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë e rezultateve të hetimit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës .
- Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 58, pika 1/ c dhe nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Metalla, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë e publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
U shpall në Tiranë, më datë 23.07.2018.

ANTARËT E TRUPIT GJYKUES:

Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI

Anëtare

Etleda ÇIFTJA

Relatore

Xhensila PINE

Sekretare gjyqësore

Anisa DUKA